



Prishtinë: 24 qershor 2008  
Kodi i ZRRE-së: D\_100\_2008  
Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_R\_95\_06\_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_R\_95\_06\_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

**Në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2008 nxori këtë:**

## VENDIM

**PJESËRISHT PRANOHET** ankesa e konsumatorit z. Naim Bujupi, Restorant-Piceria "LUMI" (shifra e konsumatorit në KEK: DPR – 2002340) nga Komorani (komuna e Drenasit) për arsytet e paraqitura në Arsyetimin e këtij vendimi.

## Arsyetim

1. Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK në ZRRE me datë 25 qershor 2007 ka apeluar përgjigjen e Departamentit për Konsumator në KEK të datës 21 qershor 2007 duke kundërshtuar ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.
2. Me datë 24 maj 2007 ekipet e kontrollës së KEK Sh.A gjatë kontrollës në teren kanë gjetur se konsumatori është i kyçur në rrjetin e tensionit të ulët me nr. njehsori 12439257 dhe se dy urat e tensionit janë të larguara dhe se nuk është duke u regjistruar energjia e shpenzuar. Me këtë rast ata kanë regjistruar pajisjet e konsumatorit dhe i kanë shënuar ato në procesverbalin e përpiluar në vendin e ngjarjes.

**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 017409 i datës 24 maj 2007.

3. Me datë 30 maj 2007 KEK Sh.A – njësia e Rrjetit në Prishtinë e ka ngarkuar konsumatorin me shfrytëzim të paautorizuar nëpërmjet faturës DPR07HP03027 në shumë prej 1,019.27 €.

**Provë:** Fatura e KEK-ut DPR07HP03027 e datës 30 maj 2007.



4. Me datë 01 qershor 2007 KEK Sh.A lëshon një Urdhër Lejimi/Ngarkimi për konsumatorin në të cilin thuhet: "RCO1-i-korrigjim nga gabimet në faturim, fatura "rikthim i humbjeve" gabimisht është kalkuluar (për 6 muaj) duhet të faturohet për 24 muaj, sipas procesit të kontrollit nr. 017409 dt. 24 maj 2007". tek ky urdhër lejim / ngarkim nr. 13843 shihet se është korrigjuar konsumatori me shumën -1,018.27 €.

**Provë:** Urdhër Lejimi / Ngarkimi i datës 01 qershor 2007.

5. Me datë 01 qershor 2007 KEK Sh.A – njësia e Rrjetit në Prishtinë e ka ngarkuar konsumatorin me shfrytëzim të paautorizuar nëpërmjet faturës DPR07HP03032 në shumë prej 4,077.07 €.

**Provë:** Fatura e KEK-ut DPR07HP03032 e datës 01 qershor 2007.

6. Me datë 01 qershor 2007 konsumatori ka parashtruar një kërkesë në shërbimin për konsumator në KEK duke kërkuar lidhje të re.

**Provë:** Dëftesa e kërkesës së konsumatorit në KEK.

7. Me datë 12 qershor 2007 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK.

8. Me datë 21 qershor 2007 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesin e kontrollës.

**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 21 qershor 2007.

9. Me datë 06 gusht 2007 konsumatori bënë ankesë në KEK duke kërkuar që të del ekipi i kontrollës në vendin e ngjarjes për verifikim.

**Provë:** Dëftesa e ankesës së konsumatorit në KEK.

10. Procesverbali i KEK-ut me nr. 014504 në të cilën nuk është shkruar data për konsumatorin "LUMI" gjatë një kontrole tek konsumatori cek se do të paguan sot 1000 € dhe nesër 2000 € ndërsa sa i përket shkyçjes nuk ka mundësi teknike për shkak të disa problemeve në shtyllë dhe se njëra fazë nuk është e futur në njehsor dhe se njehsori është dëmtuar dhe se duhet të ndërrohet.

**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 014504.

11. Me datë 04 shtator 2007 lëshohet një Procesverbal i KEK-ut Nr. 011299 i përpiluar për konsumatorin "Lumi" me nr. njehsori 43263691 në të cilin ceket se: "Konsumatori nuk lejon shkyçjen me arsytim se me datë 01 shtator 2007 ka bërë pagesën në vlerë prej 1,000.00 €, dhe se lëndën e ka në gjykatë".

**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 011299.



12. Me datë 04 shtator 2007 konsumatori ka bërë aplikimin për zëvendësim - kalibrim të njehsorit.

**Provë:** Aplikimi për zëvendësim – kalibrim të njehsorit

13. Me datë 05 shtator 2007 KEK-u - Divizioni i Rrjetit lëshon një Vërtetim mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik për konsumatorin me anë të cilës hiqet njehsori me nr. 12439257 dhe vendoset njehsorin me nr. 43263691. Në këtë Vërtetim ceket “Klema e djegur e fazës T”.

**Provë:** Vërtetimi i KEK-ut mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik.

14. Me datë 02 tetor 2007 KEK-u përpilon një Procesverbal nr. 028163 për konsumatorin me nr. njehsori 43263691 në të cilin ceket se: “Konsumatori borxhin e ka kontestues dhe pret vendimin nga Gjyqi, andaj nuk lejon shkyçjen pasi që e kanë ngarkuar tepër me rrymë”.

**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 028163 i datës 02 tetor 2007.

15. DMK në ZRRE ka kërkuar dokumente shitesë nga KEK-u për të shpjeguar se pse konsumatori njëherë është faturuar me anë të faturës me shfrytëzim të paautorizuar për gjashtë muaj dhe se menjëherë pas dy ditëve ka korrigjuar atë shumë dhe ka ngarkuar konsumatorin me shfrytëzim të paautorizuar për 24 muaj.

16. Me datë 28 janar 2008 KEK-u i ka dërguar DMK në ZRRE shpjegimin dhe ka theksuar se fatura për 6 muaj është faturuar nga shërbimi i faturimit ndërsa sipas procedurës është dashur të faturohet për 24 muaj. Poashtu në dokumentet e dërguara nga KEK-u ceket se korrigjimi është bërë pasi që shërbimi i faturimit ka gabuar gjatë llogaritjes dhe se konsumatori duhet të faturohet për 24 muaj.

**Provë:** Sqarimi i KEK-ut rreth faturimit dhe dokumenti me anë të së cilës iu është bërë korrigjimi konsumatorit.

17. DMK e ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga KEK Sh.A dhe konsumatori i **rekomandon** Bordit të ZRRE-së që **pjesërisht të pranohet** ankesa e konsumatorit në arsyetimin se:

**17.1** Konsumatori ka bërë shkelje të procedurave dhe kornizës ligjore në fuqi me kyçe të restorantit pa pëlqimin e KEK-ut dhe për këtë arsye është bërë procesi nga ekipi i kontrollit nr. 017409, sipas së cilit pastaj është ngarkuar konsumatori për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë.

**17.2** Në procesin e kontrollës nr. 017409 theksohet se restoranti është i ri, pa cekur kohën se kur restoranti ka filluar punën.

**17.3** Bazuar në nenin 28.5 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji; vetëm në raste kur fillimi i konsumit të paautorizuar të energjisë nuk mund të caktohet atëherë supozohet se konsumi ka zgjatur 24 muaj. Në rastin konkret ekipet e KEK-ut kanë shkruar se restoranti është i ri andaj kalkulimi për 6 ka qenë më i drejtë se ai për 24 muaj.



Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që pjesërisht të pranoj ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së. Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që ta shkarkoi kartelën e konsumatorit për ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar sipas faturës DPR07HP03032 në vlerë 4,077.07 €, dhe njëkohësisht ta ngarkojë kartelën e

konsumatorit për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë për 6 muaj sipas procesit nr. 017409 dhe faturës DPR07HP030327 në vlerë 1,019.27 €.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

---

Ali Hamiti, Kryesues

---

Theranda Beqiri, Anëtare

---

Nysret Avdiu, Anëtar